

SHIFRA E NXËNËSIT

## PROVIMI I MATURËS

QERSHOR 2020

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

## U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike.

Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Testi DUHET të shkruhet LEXUESHËM me laps kimik. Nxënësi/nxënësja mund të shkruaj me shkronja dore ose shtypi. Nëse shkruan me shkronja shtypi DUHET të theksojë shkronjën e madhe.

Testi përmban detyra të cilat zgjidhen në njërën prej mënyrave në vazhdim:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë. Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes të përshkruash përgjigjet tua.

**Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:**

- është e pasaktë
- përgjigjja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë **NUK** është bart në fletën e përgjigjeve
- është rrethuar ose shkruar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë
- përgjigjja/eseja është e palexueshme dhe e paqartë
- përgjigjja/eseja është shkruar me laps të thjeshtë
- eseja **NUK** është shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në faqet e parapara **për koncept** (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Nëse gabon, vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh punën, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tua.

**Me fat!**





# FAQE E ZBRAZËT

### **Teksti 1**

Kuptimi themelor i këtij termi (lat. *communicare*) është: të bëjmë diçka të përbashkët, të ndërlihdemi. Një nga përkufizimet është se komunikimi është proces në të cilin njerëzit ndajnë informacione, mendime dhe ndjenja, që mbartin kuptime të caktuara. Kjo ka të bëjë si me fjalët e folura ose të shkruara, ashtu edhe me informacione të cilat nuk kanë nevojë të shkruhen ose të thuhën: shprehja e fytyrës, shikimi, pozita e duarve, trupit, veshja. Komunikimi është gjithashtu edhe mënyrë që të ndikojmë tek njëri-tjetri (në sjellje, vendime, ndjenja).

Në çdo komunikim ekziston një mesazh (mendim, ide, porosi joverbale). Me dërgimin e një mesazhi fillon procesi: personi i cili dëshiron ta dërgojë, përcjellë një mendim ose ide tek një person tjetër (marrësi), e bën këtë përmes një kanali (p.sh. me telefon, letër, ballë për ballë) dhe me anë të simboleve (p.sh. fjalë; gjest, shprehje të fytyrës). Për të ditur që dërgimi i mesazhit ishte i suksesshëm dhe se mesazhi ishte kuptuar ose deshifruar, duhet që nga bashkëbiseduesi të marrim ndonjë reaksion ose informacion kthesë (ang. *feedback*). Dërgimi i një mesazhi pothuajse kurrë nuk ndodhë në një „vijë të drejtë“, sepse ka shumë gjëra në fushën e komunikimit që mund të pengojnë transmetimin e saktë të mesazhit ose informacionit kthesë. Përveç zhurmës fizike, ndjenjat tona të forta, nevojat e fuqishme, sistemet e vlerave të ndryshme, dallimet në mes të brezave, stereotipet, paragjykimet („zhurma“ psikologjike ose zhurmat) – bëjnë që komunikimi të mos funksionojë mirë dhe që të mos kuptohemi menjëherë dhe mirë.


(Teksti është marrë nga: *Aspektet pedagogjiko-psikologjike të mësimdhënies*, botuesi: Enti për Shkollim, Podgoricë 2014)

### **Teksti 2**

Kanalet e komunikimit po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për të arritur qëllimet e biznesit. P.sh. marketingu(e) kërkon që të përcaktohet qëllimi dhe mënyra e përdorimit të kanalit(e) të komunikimit për realizimin e atyre qëllimeve.

Ndërsa kanalet e komunikimit(e) janë: biseda, telefoni, letrat, mediat klasike, mediat online, e-maili, web faqja, rrjetet shoqërore...

### Teksti 3



(Marrë nga <https://www.link-elearning.com>: *Bazat e komunikimit afarist*)

**1. Cili nocion i lidhë të tre tekstet?**

.....

1 pikë

**2. Ceki dy elemente nga tekstet 1 dhe 3 të cilët mungojnë ose që nuk janë të dukshëm në tekstin nr. 2.**

.....

1 pikë

**3. Nëse konstatimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse i pasaktë, rretho P dhe argumento përgjigjen.**

KONSTATATIMI	SAKTË PASAKTË	ARGUMENTIMI I PËRGJIGJES
Feedback është i perealizueshëm në situatën kur mesazhi dërgohet përmes mediave klasike (televizionit, radios, gazetave).	S      P	

1 pikë

**4. Çfarë nga teksti nr. 1 mungon në tekstin nr. 2 e që është i rëndësishëm për saktësinë e transmetimit të mesazheve?**

.....

.....

1 pikë

**5. A) Nëse dikujt i dërgon zemrën e vizatuar, mesazhi është:**

1. verbal
2. joverbal

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë.*

1 pikë

**B) Në shembullin “e zemrës”(nga detyra nën A) sqaro dekodimin.**

.....  
.....

2 pikë

**Duke shfrytëzuar tekstin zhvillo detyrat 6, 7, 8, 9 dhe 10.**

**Hamleti dënohet me tre vjet**

Shfaqja „Vazhdoni, ju lutem“, e luajtur në Teatrin Popullor Serb në Novi Sad më 29 qershor, vitin e dytë të Festivalit Shekspiri, këtë vit ishte më se interesante.

Shfaqja (e autorëve Jan Dujvendak dhe RoXher Bernat, në prodhimin e „Dreams Come True“ nga Gjeneva, Zvicra) është konceptuar si një gjykim i vërtetë i Hamletit. Që nga viti 2011, kur është shfaqur për herë të parë, deri më tash është luajtur 157 herë në vende të ndryshme, gjithnjë me pjesëmarrës të tjerë dhe rezultate të ndryshme. Sepse çdo herë zgjedhën (vetëm) tre aktorë për rolin e Hamletitit, Ofelisë dhe Gertrudës, kurse gjykatësi, prokurori, avokati, ekspertët, policët janë persona autentikë nga mjedisi i dhënë dhe gjykojnë sipas ligjeve në fuqi, me ç’rast porotë janë njerëzit nga publiku.

Hamleti në momentin e dhënë debaton me nënën e tij Gertrudën, e cila martohet me xhaxhain e tij Klaudion, për të cilin ajo e di se çfarë ka bërë dhe përpiqet që edhe të tjerëve t’ua hapë sytë, dhe kur vuri re se perdja po lëviz, duke mos ditur dhe mos parë çfarë është pas saj, dhe duke menduar se është një mi i madh, me thikë nëpër të e theri Polonin. I hutuar nga ajo që bëri pa dashje dhe nga ajo prej ka kishte ardhur aty Poloni, e transferoi trupin e tij në tarracë...

Pasuan akuzat dhe dëshmitarët, edhe ekspertët dhe të pandehurit... Ndërsa flasin, janë të kthyer me shpinë nga publiku, me fytyrë (të cilën publiku e sheh në ekran) drejt gjykatësit, kështu që në të vërtetë në rolin kryesor është vetë gjykimi. Nuk do të ishte painteres, por do të ishte tepër e gjerë të citohej ajo çfarë dikush fliste. Por, le të përmendim vetëm ndonjë detaj...

Akuza i ka shtrënguar elementet e vrasjes, duke u thirrur, ndër të tjera, edhe në nenin 113 të Kodit tonë Penal, mbrojtja thoshte se kjo nuk ishte madje as një vrasje nga pakujdesia, por një rast aksidental, pasi që Hamleti nuk ka asnjë motiv ta vrasë Polonin dhe se as që mund ta supozonte se ky fshihej ose endej pas perdes...

Interesant, posaçërisht nga pikëpamja e së vërtetës dhe drejtësisë, askush nga personat juridik nuk çante kryet për pjesën e dëshmisë së Hamletit në të cilën fliste për

Klaudion, për atë që ky e kishte kryer në mënyrë perfide, duke pushtuar pastaj edhe pushtetin dhe gruan dhe brohoritja e njerëzve në vend të burgut. Klaudie madje nuk është as i pranishëm. Ai është në Itali në udhëtimin turistik dhe në pushim...

Shfaqja kishte tri pushime. Duke pirë cigare para teatrit me konsensus u përfundua – gjykatësi është tamam i hijshëm, ka karizëm. Kurse avokati Petar Uçajev është treguar jo vetëm mjeshtër i zanatit të vet por edhe aktor i mirë. Kjo paraqitje skenike, mënyra e të drejtuarit, intonacioni që e kemi parë gjatë fjalës përfundimtare të mbrojtjes janë për çdo lëndatë.

Përshtypje mbresëlënëse që lë shfaqja është se, në të vërtetë, autorët Jan Dujvendak dhe Roxher Bernat rishqyrtojnë relacionin e teatrit dhe të drejtave, përkatësisht tregojnë se realiteti madje edhe kur është më i ashpër dhe më i vështirë, merr kuptim, madje edhe ndonjë bukuri kur përshkohet me kreativitet, dhe është jo vetëm e vështirë por edhe banale, e tmerrshme, dhe e pakuptimtë kur i merret ajo kokërr shpirtërore.

Jehonte pas shfaqjes duartrokitja e fuqishme dhe e gjatë. Duartrokiteshin fuqishëm të gjithë interpretuesit, në realitet gjykatësi Majiq më tepër për shfaqjen skenike dhe karizmin sesa për aktgjykimin.

Diku para fundit, para se Majiqi simpatik të paraqes aktgjykimin, Nikita Milivojeviq kumtoi statistikën interesante të kësaj shfaqjeje. Domethënë, në 157 gjykime të mëparshme në 13 vende Hamleti u la i lirë 79 herë. Në Cyrih, madje ishte vendosur të merrte një dëmshpërblim prej 80.000 eurosh. Dy herë lënda është kthyer për shkak të ndryshimit të aktakuzës, pastaj dy herë (në Milano) është liruar nga aktakuza për vrasje pa paramendim, por është dënua një vit me burg për shkak të ndryshimit të vendit të ekzekutimit të krimin. Një herë (në Melburn) porota nuk arriti një aktgjykim unanim. Është dënua 73 herë për vrasje të qëllimshme, me dënime nga tetë dhe 10 muaj është dënua nga një herë, nga tri herë me dy dhe tre vjet, tetëmbëdhjetë herë me pesë vjet, dhjetë herë me gjashtë vjet, nëntë herë me shtatë vjet, njëmbëdhjetë herë me tetë vjet, tri herë me 12 vjet, një herë me 15 vjet...

*(Përgatitur sipas tekstit të marrë nga <https://www.blic.rs/kultura/vesti/hamlet-u-srbiji-osudjen-na-tri-godine/d2n1d4f>)*

## **6. Në Tetarin Popullor Serb është luajtur shfaqja:**

1. *Hamleti i dënua me tre vjet*
2. *Vazhdoni, ju lutem*
3. *Dreams Come True*

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

*1 pikë*

**7. Hamleti gjykohet për:**

1. kundërshtim ndaj Klaudios
2. debat me nënën
3. vrasjen e Polonit

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

1 pikë

**8. Në tekst thuhet se shfaqja ka qenë më shumë se interesante. Në shprehje vjen edhe kreativiteti i pjesëmarrësve të shfaqjes. Duke u thirrur në tekst dëshmo konstatimet e dhëna.**

.....  
.....

2 pikë

**9. Nëse pohimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë, rretho P.**

Avokati Petar Uçajev është aktor i Teatrit Popullor Serb.	S	P
Porota në Cyrih ka vendosur që Hamletit t'i paguaj 80 000 euro.	S	P
Gjykatësi Majiq ka marrë duartrokitje të fuqishme vetëm se e dënoi Hamletin me tre vjet burg.	S	P

1 pikë

**10. Hamleti në 157 gjykimet e mëparshme është liruar nga akuza 79 herë. Duke shfrytëzuar informacionet nga teksti, shpjego përse porotat në ato vende e kanë sjellë një aktgjykim të tillë.**

.....  
.....

1 pikë

**11. Është simbol i urtësisë, i arsyes dhe i njohurive shkencore të njeriut të kësaj bote.**

**Rretho numrin para emrit të personazhit me të cilin kanë të bëjnë tiparet e dhëna dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.**

1. Antigona
2. Hamleti
3. Virgjili

1 pikë



- 12.** motivi i shëmtimit, bukuria e jetës dhe mizoria  
motivi religjioz  
motivi i hakmarrjes  
motivi heroik

**Pranë titullit të veprës letrare nga vargu i dhënë përshkruaje motivin përkatës. Kujdes, një vepër është e tepërt.**

1. *Fyelli* .....
2. *Albatrosi* .....
3. *Iliada* .....
4. *Çeta e profetëve* .....
5. *Hamleti* .....

2 pikë

**Në bazë të fragmentit të dhënë, si dhe veprës në vargje në tërësi, zhvillo detyrat 13, 14 dhe 15.**

Mjerimi ka vulën e vet të shëmtueme,  
asht e neveritshme, e keqe, e turpshme,  
balli që e ka, syt që e shprehin,  
buzët që më kot mundohen ta mshefin -  
janë fëmitë e padijes e flitë e përbuzjes,  
të mbetunat e flliqta rreth e përqark tryezës  
mbi t'cilën hangri darkën një qen e pamshirshëm  
me bark shekulluer, gjithmon i pangishëm.  
Mjerimi s'ka fat. Por ka vetëm zhele,  
zhele fund e majë, flamujt e një shprese  
të shkyemë dhe të coptuem me t'dalun bese.

Mjerimi tërbohet në dashuni epshore.  
Nëpër skaje t'errta, bashkë me qej, mij, mica,  
mbi pecat e mykta, t'qelbta, t'ndyta, t'lagta  
lakuriqen mishnat, si zhangë; t'verdhë e pisa,  
kapërthehen ndjenjat me fuqi shtazore,  
kafshojnë, përpijnë, thithen, puthen buzët e ndragta  
edhe shuhet uja, dhe fashitet etja  
n'epshin kapërthyes, kur mbytet vetvetja.

...

**13.** A) Shkruaje titullin e veprës nga e cila janë shkëputur këto vargje, si dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.

.....

1 pikë

B) Trego si përshkruhen në këtë vepër pamjet dhe fatet e njerëzve në skamje dhe vuajtje.

.....

.....

1 pikë

**14.** Cila revoltë mbizotëron në këtë vepër?

.....

1 pikë

**15.** Shkruaj ndonjë pasojë që shkakton varfëria.

.....

.....

1 pikë

**16.** Në veprën *Xha Gorio* babai tregon dashuri të pakushtëzuar për vajzat e tij. Si përfundojnë iluzionet e Xha Gorios si prind?

.....

.....

2 pikë

**17.** Cili personazh në vepër i mbetet besnik Xha Gorios deri në momentin e fundit?

.....

1 pikë

**18.** Pranë termit të dhënë shkruaj për cilën gjini letrare është karakteristike.

retrospektiva .....

remarka .....

rima .....

akti .....

1 pikë

**19.** Shkruaj emrin e epokës letrare e cila i paraprin realizmit dhe asaj që vjen pas tij.

..... → R E A L I Z M I → .....

1 pikë

**20.** Pranë vargjeve nga *Kurora e maleve* shkruaj emrin e personazhit i cili i flet ato.

1. Stambollë, o gazmend i tokës,/kupë mjalti, o mal prej sheqeri,/banjë' e ëmbël për jetë t' njerzve,/vend ku lahen n'shërbet shtojzovallet.

.....

2. Kaluar kam në shoshë e sitë,/hetuar kam këtë botë t'mbrapshtë,/pirë e kam unë gotn' e helmit,/njohur e kam unë jetn' e hillur.

.....

3. Në botë s'ka asgjë më të bukur,/se fytyra mbushur gjithë gëzim,/veçmas kështu siç është' kjo e jotja:/argjend mjekra varur gjer në brez,/argjend flokët varur gjer në brez,/qesh fytyra gjith' gëzim e hare;/bekim është kjo prej Zotit.

.....

3 pikë

**21.** alegoria      narracioni      epiteti      hiperbola

**A) Përshkruaje termin teoriko-letrar i cili nuk i përket vargut të dhënë.**

.....

1 pikë

**B) Argumento përgjigjen nën A.**

.....

.....

1 pikë

**22.** Si quhet dokumenti i pare që njohim deri sot që është shkruar në gjuhën shqipe dhe të cilin e zbuloi studiuesi rumun Nikolla Jorga në Bibliotekën Laurenciane në Firenze të Italisë?

.....

1 pikë

**23.** Në fjalën **zbardhet** është zhvilluar një ndryshim fonetik. Cili?

1. palatalizimi
2. asimilimi
3. disimilimi

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

1 pikë

**24.** A) Skruaj drejtë shkurtesat për fjalët:

1. e të tjera .....
2. Fondi Monetar Ndërkombëtar.....
3. për shembull .....

1 pikë

B) Numrin shkruaje me shkronja.

617 .....

1 pikë

**25.** A) Plotëso fjalinë me fjalën/fjalët nga kllapat, duke pasur kujdes për domethënien e saj/e tyre.

I kishte rënë diçka ..... (ndër mend / përmendsh).

1 pikë

B) Fjalës/fjalëve së/të plotësuar/a në fjalinë nën A caktoja/u rasën.

.....

1 pikë

**26.** A) Rretho numrin para personazhit i cili nuk i përket vargut të dhënë.

1. Afërdita
2. Gjenci
3. Aradi
4. Gjon Zveri

1 pikë

B) Argumento përgjigjen nën A duke emëruar veprat letrare nga të cilat janë personazhet.

.....

.....

1 pikë

**27.** Në vargjet në vazhdim dallo figurat e intonacionit dhe shkruaji ato mbi vija pranë vargjeve.

Me zjarr ju flas...me zjarr.  
në gjirin tim kam hapur varr...  
që t'i jap shpresë e t'i marr. ....

Vdiq Naimi, vdiq Naimi,  
moj e mjera Shqipëri! .....

2 pikë

**28.** A) Krahaso vargun nga poezia *Gjuha shqipe* „Porsi kanga e zogut t' verës, /Qi vallzon n' blerim t' Prillit“ me titullin e poemës idil *Bagëti e Bijqësi*. Sqaro çfarë i lidh.

.....  
.....

1 pikë

B) Shkruaj emrin dhe mbiemrin e autorit të poezisë *Gjuha shqipe*, si dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të poemës *Bagëti e Bujqësi*.

..... (autori *Gjuha shqipe*) ..... (autori *Bagëti e Bujqësi*)

2 pikë

**29.** Lexo fragmentin nga *Antigona*.

Me këto që thua më helmon dhe mua  
- e me plot të drejtë - dhe atë që vdiq.  
Lermë pra të vuaj, lermë të pësoj,  
si më këshillon koka im'e thatë;  
si do që të ngjasë, do të vdes me nder.

**A) Rretho numrin para emrit të personazhit për fatin tragjik të të cilit flitet dhe zgjedhjen barte në fletën e përgjigjeve.**

1. Antigona
2. Hemoni
3. Kreonti
4. Edipi

1 pikë

**B) Shpjego përdorimin e vizave në vargun - e me plot të drejtë – dhe atë që vdiq.**

.....  
.....

1 pikë

**30.** Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si një tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin.

Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHE FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi). Eseja DUHET të shkruhet në fletët e parapara për shkrimin e esesë (eseja e shkruar në fletët e konceptit NUK LEXOHE).

Kij kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.

### **1. Analiza e personazhit të plakës Nicë**

Plaka Nicë, plakë zemërmadhe, mbërrin në dasmë ku ishte i pranishëm dhe gjenerali. Po afronte mesnata dhe hareja ishte në kulm dhe ndoshta të gjithë e kishin harruar plakën Nicë, kur ajo erdhi prapë. Ajo erdhi pikërisht në kohën që ata dy po bëheshin gati të ngriheshin. Ndoshta, nga të gjithë ata njerëz që ishin brenda, gjenerali ishte i pari që e ndjeu. Ai e ndjeu atë si gjahtari i vjetër që ndjen tigrin në xhungël. Kur te dera njerëzit lëvizën dhe pëshpëritën dhe prapë lëvizën, tërë qenia e tij thirri "erdhi" dhe ai e kuptoi që u zverdh. Por këtë herë plaka Nicë nuk qante, askush nuk ia dëgjoi zërin, megjithëse të gjithë e ndjenin se ajo ishte atje te dera. Muzika binte, por askush nuk e dëgjonte muzikën. Te dera u grumbulluan shumë njerëz. Asnjëri nuk e kuptoi si ndodhi që plaka Nicë u fut brenda. Ndoshta ishte pamja e saj që i bëri njerëzit t'i linin rrugë, ndoshta lutjet e saj, por sidoqoftë ajo hyri dhe të gjithë lëshuan thirrje dhe zëra. Ajo ishte e lagur qull, e ngjyer e tëra me baltë, krejt e bardhë në fytyrë, si një e vdekur, dhe në krahë mbante një thes. Gjenerali pa i zotëruar dot gjunjët u ngrit në këmbë, sepse e ndjeu që gruaja kërkonte atë. Ai i doli vetë përpara, ashtu si ajo kafsha që, porsa ndjen së largu thirrjen e armikut, mpihet prej zërit të tij dhe në vend që të ikë, vrapon t'i dalë vetë përpara.

Njerëzit u mblodhën përreth dhe nuk dinë ç'të bënin. Askush nuk mendonte dot asgjë. Plaka Nicë qëndroi në vend, i nguli gjeneralit një vështrim të papërqendruar, sikur nuk vështronte atë, por hijen e tij. Përmes kollitjes ajo i tha disa fjalë, prej të cilave ai kuptoi vetëm fjalën "vdekje".

Përkthemani!-thirri gjenerali sikur kërkonte ndihmë. Por asnjëri nuk ia përktheu. Gjenerali hodhi sytë përreth dhe ndeshi në vështrimin e priftit. Prifti u afrua.

- Ajo thotë se dikur ka vrarë një oficer madhor nga tanët dhe pyet a jeni ju ai gjenerali që mbledh eshtrat e ushtarakëve,-tha prifti.

- Po, zonjë,-tha me zë të mbytur gjenerali. Ai mblodhi të gjitha forcat për të mbajtur kokën lart. Atëherë plaka Nicë se ç'tha diçka tjetër, që prifti nuk arriti ta përkthente, sepse fjalët e fundit të saj u mbuluan nga një murmuritje e fuqishme dhe, para se ta ndalonte njeri, ajo hodhi në dysheme në mes ulërimave të grave, mu në këmbët e gjeneralit, thesin që mbante në shpinë. As që ishte nevoja që prifti të përkthente diçka dhe as që duhej më asnjë përkthim, sepse çdo gjë ishte e qartë. Sytë e gjeneralit rrëshqitën nga plaka Nicë te thesi dhe nuk mund të kishte gjë më të tmerrshme se ai thes që ra me zhurmë të shurdhër në dysheme, të llangosur me copa të mëdha balte të zezë. Gratë u hodhën të lemeritura mënjanë dhe mbuluan fytyrën me duar, kurse plakat bënë kryq dhe pëshpëritën me tmerr:

- E kishte varrosur te pragu, -se kush bërtiti.

Plaka Nicë u kthye dhe iku e lagur qull dhe e ndotur me baltë siç ishte dhe asnjëri nuk mendoi më ta ndalte, sepse ç'ishte për t'u bërë, ishte bërë tashmë.

Gjenerali nuk i hiqte sytë nga thesi dhe veshët i buçisnin nga zhurma, tmerrri e thirravaja. As ai vetë nuk e kuptoi pse u bë papritur një qetësi e thellë, ose ndoshta nuk u bë fare qetësi, por ashtu iu duk. Në këmbët e tij dhe në këmbët e gjithë dasmorëve nxinte dhe heshtte ai thes i vjetër, i arnuar me copa, të cilat për çudi, ai i vuri re.

Dikush duhet të merret me të, mendoi truri i tij i mpirë.

Atëherë në mes të heshtjes u përkul ngadalë dhe me duart që i dridheshin e kapi nga gryka dhe e ngriti thesin e përbaltur. Pastaj me po ato lëvizje të ngrira e hodhi thesin në krahë dhe doli nga dera përjashta në shi, i kërrusur e i mpirë, sikur të mbante mbi supe turpin dhe peshën e gjithë botës. Prifti e ndoqi pas.

Prapa krahëve të tyre se kush ia dha kujës.

### **Udhëzime për shkrimin e esesë Analiza e personazhit të plakës Nicë:**

→ Shkruaj kush është autori i këtij fragmenti.

→ Si titullohet romani ku bën pjesë ky fragment, nga sa pjesë përbëhet ai dhe si zhvillohen ngjarjet në këtë roman?

→ Për subjektin që trajtohet në këtë pjesë, dhe për ndonjë figurë stilistike që përdor autori.

→ Për personifikimin e plakës Nicë, shqetësimin e saj.

→ Pse themi se plaka Nicë është fatkeqja Nicë dhe për çfarë kishte ardhur gjenerali në Shqipëri?

## 2. Lexoj edhe atë që (nuk) më duhet

### Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Çfarë dëshiron të lexosh dhe përse?
- Shkruaj në çfarë të asocion fjala *lektyrë*.
- Janë të ndara mendimet për atë nëse është e nevojshme të lexohen veprat letrare të cilat para 2-3 deceniesh janë përfshirë në programin e lëndës. Çeke titullin e veprës letrare (përveç epeve dhe këngëve epike) në bazë të së cilës në formë të argumentuar do ta kumtosh qëndrimin tënd PËR leximin e lektyrës ose KUNDËR tij.
- Për epet dhe këngët popullore epike të rinjtë thonë se nuk i kuptojnë të gjitha fjalët, se zhvillimi i ngjarjes është i largët dhe i mërzitshëm. Shkruaj titullin e epit dhe këngës epike në bazë të të cilëve do ta argumentosh qëndrimin tënd për ato vepra letrare.
- Për t'u sjellë më afër nxënësve të shkollave të mesme veprat letrare të vlefshme, në periudhën e komunikimeve moderne, aktori Ivan Jevtoviç, me kolegët e tij, projektoji Teatrin e Lektyrës "Vlladimir Jevtoviç". Nëpërmjet lojës dhe aktrimit, me biseda dhe sugjerime të nxënësve, por edhe profesorëve, në repertor janë edhe veprat e lektyrës nga shkolla e mesme. Çdo interpretim të shfaqjes e përcjell punishtja në të cilën nxënësit të cilët janë publiku, diskutojnë me aktorët dhe profesorët. Mund të zgjedhin skena të cilat dëshirojnë t'i shikojnë përsëri ose t'i ndryshojnë si regjisor dhe t'i bëjnë aktorët t'i luajnë ato sipas skenarit të tyre. Qëllimi është një kuptim i duhur dhe më i mirë i veprës. Shprehe me argumente mendimin tënd për këtë shembull dhe ide.
- Kumto propozimin tënd/propozimet tua çfarë të bëhet që të rritet përqindja e nxënësve të cilët lexojnë vepra letrare të parapara me programin e lëndës.

25 pikë





## KONCEPTI I ESESË

A series of horizontal dotted lines for writing, consisting of 30 lines spaced evenly down the page.

A series of horizontal dotted lines providing space for writing.

## ESEJA

A series of horizontal dotted lines for writing an essay.







1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				
15.				